



Nr. \_\_\_\_ Prot.

Nr. \_\_\_\_ Prot.

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Sot më datë 13.01.2011 nënshkruhet ky Memorandum Mirëkuptimi mes:

- Universitetit të Tiranës; dhe
- Akademisë së Arteve, Tiranë;
  
- ❖ Duke pasur në konsideratë se Universiteti i Tiranës dhe Akademia e Arteve janë Institucione të Arsimit të Lartë Publik, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar;
- ❖ Duke vlerësuar performancën e lartë dhe standartet e vendosura në mënyrë të ndërsjellë në fushat arsimore përkatëse;
- ❖ Me qëllim përmbushjen e objektivave afatgjate të ndërsjella për zgjerimin e hapësirave të komunikimit në fushën akademike për stafet pedagogjike dhe studentët;
- ❖ Me dëshirën për krijimin e kushteve të favorshme për rritjen e vazhdueshme të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve si dhe mes strukturave përbërëse të ndërsjella;

### **Universiteti i Tiranës dhe Akademia e Arteve (Palët)**

nënshkruajnë këtë Memorandum Mirëkuptimi dhe angazhohen për zbatimin e pikave sa më poshtë:



1. Palët i sigurojnë njëra tjetrës dhënien e informacioneve me karakter akademik statistikor, i cili do të përdoret në përputhje me qëllimet e deklaruara të palëve;
2. Palët angazhohen të krijojnë akses dhe të japin dokumentacion njëra tjetrës, lidhur me përmbajtjen e programeve të studimit të secilës palë. Strukturat përbërëse të secilës palë mund të përcaktojnë bashkërisht mënyrën konkrete të komunikimit mes tyre;
3. Palët angazhohen për krijimin e kushteve për shkëmbin e studentëve që vazhdojnë studimet në secilin prej institucioneve të arsimit të lartë palë të këtij Memorandumi, duke synuar përplotësimin e njohurive në fusha përkatëse të studimit.
4. Palët angazhohen për krijimin e mundësive dhe lehtësive të nevojshme për shkëmbimin e pedagogëve gjatë procesit mësimor në fusha të përafërta të studimit.
5. Palët angazhohen që të zbatojnë pikat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi në mënyrë të veçantë në fushat filologjike e muzikore.
6. Palët angazhohen të zgjerojnë më tej dhe të shfrytëzojnë çdo mundësi për rritjen e bashkëpunimit të ndërsjellë, në fushat me interes të përbashkët dhe duke respektuar interesat e secilës palë në veçanti.

Ky Memorandum Mirëkuptimi nënshkruhet nga Rektori I Universitetit të Tiranës dhe nga Rektori i Akademisë së Arteve dhe hyn në fuqi menjëherë.

Nënshkruar në Tiranë, sot më datë 13 Janar 2011

**UNIVERSITETI I TIRANËS**

**REKTORI**

**Prof. Dr. DHORIS KULE**



**AKADEMIA E ARTEVE**

**REKTORI**

**Prof. Dr. PETRIT MALAJ**